



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### THIRRJE PËR APLIKIM

Në zbatim të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.786 datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, si dhe në bazë të vendimit nr.75, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) ka miratuar realizimin e kontrollit të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Për realizimin e këtij procesi do të angazhohet një grup prej 7 (shtatë) anëtarësh, i përbërë nga 2 (dy) Inspektorë të Lartë të Kontrollit të Cilësisë të Strukturës Mbështetëse të BMP’së dhe 5 (pesë) auditues ligjorë anëtarë të asamblesë së përgjithshme.

Kriteret që duhet të përmbushen nga aplikantët janë:

1. Të jenë anëtarë të Asamblesë së përgjithshme të organizatës profesionale të audituesve ligjorë IEKA;
2. Të mos kenë qenë pjesë e organeve drejtuese të IEKA’s gjatë 5 viteve të fundit;
3. Të mos kenë qenë subjekt i masave disiplinore nga BMP apo IEKA.

Lutemi të paraqesni kërkesën tuaj drejtpërdrejtë pranë strukturës mbështetëse të BMP-së, në adresën [info@bmp.al](mailto:info@bmp.al) **brenda ditës së Premte datë 04 Qershor 2021.**